



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe neni 127 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rregullores Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta

- I. Miratohet Rregullorja Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta.
- II. Rregullorja si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.03.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 99, 100 dhe 127 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 20, 25 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 28.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR.09/2024

REGJISTRIMI DHE VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit, evidentimit dhe votimit të personave me nevoja të veçanta (VPNV) në ditën e zgjedhjeve, nga Komisioni i Votimit të Ekipit Lëvizës (KVEL), të organizuara nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), në komunën përkatëse.

Neni 2

Regjistrimi i votuesve me nevoja të veçanta

1. Votues me nevoja të veçanta, konsiderohen votuesit me zotësi juridike që nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotim (VV), për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër.
2. Votuesi me zotësi juridike, i cili dëshiron të regjistrohet si votues me nevoja të veçanta, duhet të aplikojë për regjistrim përmes platformës elektronike ose fizikisht në zyrët e KKZ përkatëse.
3. Kërkesa për regjistrim, bëhet duke bashkangjitur dokumentet, si në vijim:
 - 3.1. Njërën nga dokumentet e vlefshme të identifikimit: letërnjoftim, pasaportë apo lejen e vozitjes);

- 3.2. një kopje të certifikatës së paaftësisë, diagnozës mjekësore, ose dëshmi tjetër relevante në mbështetje të aplikimit të tij/saj.
- 3.3. fotografimin e votuesit me dokumentin identifikues në dorë.
4. Organizatat joqeveritare (OJQ) të cilat janë të regjistruara dhe të specializuara për ndihmë personave me nevoja të veçanta, mund të pranojnë formularë dhe dokumentet sipas kërkesave në paragrafin 3 të këtij neni dhe ti dorëzojnë ato në KKZ me autorizim të noterizuar të aplikantëve.
5. KKZ, brenda dy (2) ditëve nga parashtrimi i kërkesës, do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat për regjistrim dhe do t'i informojë me shkrim, të gjithë aplikuesit nëse kërkesa e tyre është aprovuar apo refuzuar.
6. KKZ informon aplikuesit të cilëve u janë refuzuar kërkesat, se ata mund të votojnë personalisht në VV e caktuar, ose të kërkojnë korrigjim ligjor brenda afatit të dhënë në njoftim, në pajtim me nenin 10 të kësaj Rregullore.
7. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, KKZ:
- 7.1. Përgatit listën e votuesve me nevoja të veçanta, me këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, adresën e shtëpisë dhe numrin e telefonit;
- 7.2. jo më vonë se 48 orë para hapjes së VV, bën ndarjen e listës sipas adresave, në atë mënyrë që votuesit nga një zonë e njëjtë gjeografike të vizitohen nga i njëjti KVEL.

Neni 3

Regjistrimi i votuesve në institucione

1. Votues në institucione konsiderohen votuesit me zotësi juridike, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara për të moshuarit, personat në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit.
2. KQZ, përmes memorandumeve të bashkëpunimit me institucione relevante, bën evidentimin e këtyre votuesve.
3. KKZ identifikon institucionet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda komunës së vet. Shërbimi i votueseve (SHV) në bashkëpunim me administratën e institucioneve, bën evidentimin e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote në këto institucione, jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kjo evidencë duhet të përfshijë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, gjininë dhe numrin e telefonit, nëse e ka.
4. SHV, organizon regjistrimin e votuesëve në:
- 4.1. Institucionet e hospitalizimit;
- 4.2. shtëpitë e të moshuarëve;

4.3. strehimoret për mbrojtjen e viktimave

5. Votuesit e kategorizuar sipas paragrafit 4 të këtij nenit, mund të regjistrohen edhe individualisht përmes platformës elektronike.
6. Lista votuese të identifikuar nga institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje, dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit, konsiderohen si votues të regjistruar.
7. KQZ përgatit fletëvotimet dhe materialet tjera, në bazë të të dhënave të votuesve sipas komunës e origjinës.
8. Në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, SHV konfirmon listën e votuesëve të të gjitha institucioneve, së paku 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.
9. Për raundin e dytë të zgjedhjeve, SHV mundëson regjistrimin e votuesëve përmes platformës elektronike.

Neni 4

Regjistrimi i votuesve në rrethana të veçanta

1. Votues në rrethana të veçanta konsiderohen votuesit që për shkaqe sigurie dhe votusit që janë në arrest shtëpiak nuk mund të votojnë në VV e tyre të caktuar.
2. Votuesit që për shkaqe sigurie nuk mund të votojnë në VV mund të regjistrohen përmes platformës elektronike si dhe duke kërkuar asistimin nga KKZ, për regjistrimin fizik.
3. SHV në bashkëpunim me institucionet përkatëse, bën evidentimin e të gjithë qytetarëve në arrest shtëpiak me të drejtë vote. Kjo evidencë duhet të përfshijë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, gjininë, numrin e telefonit dhe adresën e banimit.
4. KKZ, jo më vonë se 48 orë para hapjes së VV, bën ndarjen e listës sipas adresave, në atë mënyrë që votuesit nga një zonë e njëjtë gjeografike të vizitohen nga i njëjti KVEL.

Neni 5

Afati i Regjistrimit dhe konfirmimit të LV për VPNV

1. Periudha e regjistrimit përmes platformës elektronike dhe në KKZ, fillon në ditën e certifikimit të Listës Votuese (LV) dhe përfundon të mërkurën e fundit para ditës së zgjedhjeve, në ora 16:00.
2. SHV, jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve konfirmon listën votuese të VPNV të pranuar nga institucionet përkatëse, sipas paragrafit 6 të nenit 3 dhe paragrafit 3 të nenit 4 të kësaj rregullore.

3. Ekipe të regjistrimit për institucionet si në paragrafin 4 të nenit 3 të kësaj rregullore, fillojnë regjistrimin e votuesëve jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon të mërkurën e fundit para ditës së zgjedhjeve.
4. SHV, jo më vonë se 48 orë para hapjes së VV bën konfirmimin përfundimtar të LV për VPNV.

Neni 6

Shënjimi i votuesve të regjistruar në LV

SHV, jo më vonë se një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve, i shënjon (vulosë) në LV dhe bën të qartë që votuesi nuk mund të votojë në VV.

Neni 7

Përbërja dhe përgjegjësitë e KVEL

1. KVEL përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë, të cilët nominohen nga subjektet politike sipas Rregullores zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimit.
2. KKZ, rekomandon KQZ numrin e KVEL të nevojshëm në komunën përkatëse, për të udhëhequr procesin e votimit të votuesve me nevoja të veçanta, votuesit në institucione dhe votuesit në rrethana të veçanta.
3. KKZ informonë paraprakisht vëzhguesit e akredituar për vendin dhe orararin e planifikuar, për t'u mundësuar vëzhguesve që t'i shoqërojnë ata në vizitat e tyre të votuesit me nevoja të veçanta, votuesit në institucione dhe votuesit në rrethana të veçanta.
4. KVEL shënon të dhënat e rëndësishme përkitazi me zhvillimin e VPNV në librin e votimit.
5. Procesi i VPNV, zhvillohet prej orës 07:00 deri 19:00.

Neni 8

Ndarja e fletëvotimeve për VPNV

1. SHV, bën ndarjen e fletëvotimeve për VPNV, nga paketimet rezervë të fletëvotimeve.
 - 1.1. Fletëvotimet ndahen për votuesit në institucione dhe votimin me ekipe mobile për votuesit me nevoja të veçanta;
 - 1.2. për zgjedhjet lokale, SHV sigurohet që të bëjë ndarjen e fletëvotimeve për votuesit në institucione sipas komunës ku votuesi është në LV.
2. SHV përgatitë pakon me material të ndjeshëm e cila përmbanë: LV, fletëvotimet, ngjyrën matrikuluese dhe vulën, për secilin ekip të KVEL.

Neni 9

Procesi i votimit

1. KKZ bën përgatitjet e nevojshme për votim, si dhe informon administratën e institucioneve përkatëse për planin dhe orarin e KVEL për votim në institucione dhe në shtëpi për VPNV.
2. Për votimin në institucionet e hospitalizimit, shtëpitë e të moshuarëve dhe strehimoret për mbrojtjen e viktimave, KKZ sigurohet që të bëjë identifikimin e hapësirave të votimit si dhe të bëjë përgatitjet paraprake për proces të njëjtë si ai i votimit me kusht.
3. KVEL zbaton procedurat e njëjta për votim, siç përcaktohet sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.
4. Para nisjes, nën monitorimin e KKZ dhe çdo vëzhguesi të pranishëm, KVEL:
 - 4.1. Merr nga KKZ pakon me material të ndjeshëm që përmbanë: LV, fletëvotimet, ngjyrën matrikuluese dhe vulën.
 - 4.2. mbyll kutinë e votimit dhe shënon numrin e shiritave mbyllës të sigurisë, numërin e fletëvotimeve të pranuara, në formularin e të dhënave për VPNV – shtojca -I, të bashkangjitur;
 - 4.3. pranon listën e VPNV e cila përmbanë adresat dhe numrat e kontaktit të votuesëve në LV, për kategorinë e votuesëve sipas nenit 2 dhe 4 të kësaj rregullore;
 - 4.4. pranon librin e votimit.
5. KVEL, te çdo votues/e, para procesit të votimit, kryen veprimet si në vijim:
 - 5.1. Tregon distinktivët identifikues, të dhënë dhe të vulosur nga KKZ, gjatë gjithë kohës sa zgjatë procesi;
 - 5.2. kërkon nga votuesi që të identifikohet, duke përdorur një dokument identifikimi dhe sigurohet që votuesi figuron në LV të pranuar në KKZ;
 - 5.3. pas konfirmimit udhëzon votuesin të nënshkruaj në LV dhe i jep atij fletëvotimin. dhe do të udhëzohet për procedurat e votimit, duke garantuar fshehtësinë e votës;
 - 5.4. për zgjedhjet lokale, KVEL udhëzon votuesin të nënshkruaj në LV dhe i jep atij fletëvotimet dhe zarfin e fshehtësisë.
 - 5.5. i jep votuesit një fletëvotim tjetër, nëse ai/ajo e ka dëmtuar fletëvotimin e parë, ruan fletëvotimin e dëmtuar dhe e regjistron si “i dëmtuar”;
 - 5.6. siguron që, pas plotësimit të fletëvotimit(eve), votuesi të fus fletëvotimin(et) në zarfin(at) e fshehtësisë. Pas mbylljes së zarfit, votuesi do ta vendosë atë në kutinë e votimit.
6. Nëse KVEL identifikon se votuesi nuk gjendet në adresën e vendbanimit, ose konstaton se votuesi refuzon të votojë, rastin e evidenton në librin e votimit.

7. Në fund të procesit, KVEL mbyllë vrimën e kutisë së votimit dhe evidenton në formularin shtojca - I, të dhënat për: numërin e fletvotimeve të përdorura, numërin e fletëvotimeve të pa përdorura, numërin e fletvotimeve të dëmtuara, numërin e votuesëve të nënshkruar në LV, numërin e shiritit mbyllës të kutisë dhe kohën e përfundimit të votimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KVEL.
8. KVEL pas evidentimit në formular dërgon të gjitha materialet në QKN sipas procedurave të parapara me Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit.

Neni 10

E drejta e ankesës

1. Çdo votues i regjistruar si votues me nevoja të veçanta në KKZ, si rezultat i ndryshimit të rrethanave të caktuara, mund të kërkojë nga KKZ të rikthehet si votues i rregullt në VV, por jo më vonë se të mërkurën e fundit para ditës së zgjedhjeve.
2. KKZ duhet të njoftojë me shkrim çdo votues me zotësi juridike, të cilit i është mohuar kërkesa për VPNV, jo më vonë se 24 orë pas parashtrimit të kërkesës, duke e informuar për të drejtën e ankesës në PZAP.

Neni 11

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr. 09/2023 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta, e datës 09.03.2023.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore, janë:
 - 2.1. Shtojca I - Formularin e të dhënave për VPNV.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Stamp: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
CENTRALNA ZBORNA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe neni 127 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

- I. Miratohet Rregullorja Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve.
- II. Rregullorja si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.03.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nën paragrafëve 2.1 dhe 2.2, nenit 3, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 110, 111 dhe nenit 127 të Ligjit Nr. 08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LPZ), si dhe nenit 8, 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L- 072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 28.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR.14/2024
QENDRA E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE (QNR)

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton mbikëqyrjen, pranimin dhe kontrollimin e materialit, kontrollin dhe verifikimin e formularëve të rezultateve, procedurën e numërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), verifikimin e zarfeve të fletëvotimeve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve për votim jashtë vendit, skanimin dhe krahasimin e listës votuese, ankesat lidhur me procesin e punës në QNR si dhe tabulimin dhe publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 2
Funksionalizimi i QNR

1. Departamenti për Operacione Zgjedhore, Edukim, Informim, Analiza dhe Trajnime (DOZEIAT), kujdeset që një herë në vit të bëjë analizën dhe vlerësimin e hapësirës për QNR.
2. KQZ, jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve, funksionalizon QNR.

Neni 3
Kriteret teknike

1. Për funksionimin e QNR duhet të plotësohen kriteret, si në vijim:
 - 1.1. kapacitete dhe hapësirë të mjaftueshme brenda;
 - 1.2. së paku një hyrje lehtësisht të qasshme;
 - 1.3. dalje emergjente;

- 1.4. hapësirë të parkingut;
- 1.5. energji elektrike;
- 1.6. infrastrukturë hidrosanitare;
- 1.7. rrjetin e internetit;
- 1.8. sistemin e ngrohjes dhe ventilimit;
- 1.9. pajisje kundër zjarrit;
- 1.10. ndriçim të mjaftueshëm;
- 1.11. inventarin.

Neni 4 **Menaxhimi i QNR**

1. QNR menaxhohet nga drejtori i DOZEIAT.
2. Gjatë procesit zgjedhor, me qëllim të përmbushjes së funksioneve Drejtori i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) obligohet të themelojë një trup mbështetëse, i cili përbëhet nga këto njësi:
 - 2.1. Departamenti i Teknologjisë Informative Zgjedhore (DTIZ);
 - 2.2. Divizioni për Mbështetje të Operacioneve Zgjedhore dhe Koordinim në Teren;
 - 2.3. Divizioni për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta;
 - 2.4. Divizioni i Trajnimit;
 - 2.5. Divizioni i Shërbimit Votues.
3. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QNR, mbikëqyren nga anëtarët e KQZ.
4. KQZ rekruton staf për të mbështetur punën në QNR, harton skemën organizative për funksionimin e QNR dhe mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve që zhvillohen në QNR.

Neni 5

Funksionet e QNR

1. QNR shërben për këto aktivitetet dhe funksione:
 - 1.1. depo e materialit zgjedhor;
 - 1.2. hapësirë për trajnimin e stafit zgjedhor;
 - 1.3. pranimin e materialit zgjedhor nga KKZ dhe nga përfaqësitë diplomatike;
 - 1.4. skanimi dhe krahasimi i Listës Votuese;
 - 1.5. hapësirë për shërbimin votues për pranimin dhe vlerësimin e zarfeve nga votimi me postë;
 - 1.6. numërimin e fletëvotimeve;
 - 1.7. tabulimin dhe publikimin e rezultateve përfundimtare të votave të kandidatëve dhe subjekteve politike;
 - 1.8. si dhe funksionet tjera në përputhje me rregulloret zgjedhore.

Neni 6

Detyrat dhe përgjegjësitë e QNR

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e QNR, janë:
 - 1.1. pranimi dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore;
 - 1.2. sigurimi i mbarëvajtjes së punës;
 - 1.3. planifikon orarin e punës sipas vëllimit të punës;
 - 1.4. skanimi i formularëve të rezultateve dhe publikimi i tyre në vendet e qasshme për vëzhguesit si dhe ofrimi i tyre për subjektet politike dhe kandidatët, sipas kërkesës;
 - 1.5. përgatitja dhe publikimi i rezultateve preliminare të votimit me kusht, VPNV dhe votimit jashtë vendit, si dhe rinumërimin sipas vendimit të KQZ;
 - 1.6. publikimi i rezultateve përfundimtare;

- 1.7. sigurimi i qasjes së vëzhguesve në secilin proces;
 - 1.8. raportimi në baza ditore në KQZ;
 - 1.9. përgatitja e rekomandimeve për KQZ.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të QNR, janë:
 - 2.1. zbatimi vendimeve të KQZ;
 - 2.2. udhëheqja e punës ditore në QNR;
 - 2.3. mbajtja e evidencës së punës të stafit të angazhuar në QNR;
 - 2.4. përgatitja e raporteve ditore për KQZ;
 - 2.5. mbajtja e evidencës për pranimin dhe dorëzimin e materialeve.
 3. Përveç detyrave të cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, KQZ sipas nevojës cakton edhe detyra të tjera.

Neni 7 **Orari i punës**

Orari i rregullt i punës në QNR është nga ora 08:00 deri në ora 24:00 dhe zhvillohet në dy ndërrime të punës, nga ora 08:00 – 16:00 dhe prej 16:00 – 24:00.

Neni 8 **Përgatitja e hapësirës**

1. Përpara hapjes së QNR, me qëllim të fillimit dhe mbarëvajtjes të punës, Stafi i KQZ përgatitë infrastrukturën e nevojshme logjistike.
2. Ndarja e hapësirave brenda QNR bëhet duke mundësuar kryerjen e funksioneve për:
 - 2.1. pranim të materialit;
 - 2.2. numërim;
 - 2.3. skanim dhe futjen e të dhënave;

2.4. arkivim.

Neni 9

Regjistrimi i ambienteve të QNR me kamera të sigurisë

1. Në QNR, instalohen kamera vëzhguese, që mbulojnë gjithë hapësirën e sallës në QNR, përfshirë vendet ku bëhet pranimi dhe ruhen materialet zgjedhore.
2. Kamera gjatë gjithë kohës duhet të regjistrojë të gjithë hapësirën, pavarësisht nga orientimi i kërkuar në momente të caktuara dhe të mundësojë video regjistrimin.
3. Procesi i regjistrimit në QNR, duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për së paku 2 (dy) orë, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Neni 10

Pranimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor nga QNR në KKZ

1. Në QNR, bëhet përgatitja, klasifikimi dhe shpërndarja e materialit zgjedhor për secilën komunë, shtojca- I- Formulari i pranim dorëzimit nga QNR në KKZ.
2. Aktivitetet si në paragrafin 1 të këtij nenit, bëhen në përputhje me procedurat e miratuara nga KQZ.

Neni 11

Ndarja e hapësirave brenda QNR për aktivitetet zgjedhore

1. Jo më vonë se dhjetë (10) ditë para ditës së zgjedhjeve, QNR, ndanë dhe përgatitë hapësirat e veçanta për:
 - 1.1. pranimin e kutive të votimit, selektimin dhe sistemimin e tyre sipas komunave, QV dhe VV;
 - 1.2. skanimin e Listave Votuese, futjen e të dhënave nga formularët e rezultateve dhe verifikimin e tyre;
 - 1.3. procesin e numërimit për ekipet e numërimit;
 - 1.4. arkivimin e dokumenteve sipas komunave, QV dhe VV;
 - 1.5. verifikimin e zarfeve.

2. Përbashimisht paragrafit 1 të këtij neni, QNR ndan hapësirat për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve tjera të parapara në nenin 5 të kësaj rregullore.

Neni 12

Pranimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor nga QKN në QNR

1. Pas përfundimit të procesit të numërimit në QKN, bëhet kthimi i materialit zgjedhor nga secila komunë.
2. QNR, pranon dhe kontrollon materialin zgjedhor të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm nga secila komunë.
3. Gjatë procesit të dorëzim-pranimit të materialeve zgjedhore nga QKN në QNR, kryen këto veprime:
 - 3.1. shënojnë dhe verifikojnë në procesverbalin e dorëzim-pranimit, numrat e shiritave të sigurisë, me të cilat është mbyllur kutia e votimit;
 - 3.2. në rast mospërputhjeje të shiritave mbyllës, QNR konstaton mospërputhjen, evidenton menjëherë në procesverbalin e dorëzim-pranimit, bashkë me sqarimin nga kryesuesi i KKZ përkatëse.
4. QNR, pranon dhe verifikon kutinë e votimit dhe zarfin e pranim-dorëzimit nga QKN e cila përmban:
 - 4.1. kutinë e votimit me fletëvotime;
 - 4.2. Listën Votuese – LV;
 - 4.3. FRS dhe FRK;
 - 4.4. Fletët Llogaritëse të Kandidatëve – FLLK;
 - 4.5. FVK për vendvotimet me kusht;
 - 4.6. Formulari i Përputhjes së të Dhënave – FPD – për Votimin e Personave me Nevoja të Veçanta – VPNV;
 - 4.7. librin e votimit;

- 4.8. formularin e pranimi - dorëzimit nga KVV në QKN.
5. Pas verifikimit dhe pranimi të materialit, QNR përmes platformës elektronike gjeneron procesverbalin e dorëzimit – pranimi, Formulari përmban: kohën e dorëzimit–pranimi, numrin e QV, të VV, numrin e shiritave të sigurisë të kutisë së mbyllur, hapësirën për përshkrimin e mospërputhjeve ose parregullsive të konstatuara, hapësirën për materialet që mungojnë, si dhe hapësirën për nënshkrimet për Kryesuesin e KKZ dhe zyrtarin pranues në QNR.
 6. Shtojca -II- Formulari i pranim–dorëzimit nga KKZ në QNR, i bashkëngjitet zarfit me dokumente të pranuar nga QKN.
 7. QNR proceson për skanim Librin e Votimit dhe Listën Votuese, ndërsa kutinë e votimit dhe materialet tjera jo të ndjeshme i proceson në arkivim, përkatësisht në depo.

Neni 13

Klasifikimi dhe sistemimi i materialit

1. QNR, pas pranimi dhe regjistrimit të materialit zgjedhor, bënë klasifikimin dhe sistemimin e materialeve, si në vijim:
 - 1.1. materialet të ndjeshme dhe jo të ndjeshme;
 - 1.2. materialet sipas Komunës, QV dhe VV;
 - 1.3. materialet e VV me kusht sipas komunës;
 - 1.4. materialet e VPNV, sipas komunës;
 - 1.5. materialet e votimit jashtë vendit, sipas shteteve.

Neni 14

Skanimi i Listave votuese të VV të rregullta dhe regjistrimi i LV të Votimit me Kusht dhe VPNV

1. Menjëherë pas pranimi të materialit nga QKN, QNR skanon në mënyrë të dyfishtë Listat Votuese të Vendvotimeve të rregullta, Votimit me Kusht dhe VPNV.
2. QNR menjëherë pas skanimit të dyfishtë bënë krahasimin e Listës Votues të votimit të rregullt me Listë e Votimit me Kusht dhe VPNV.

3. QNR pas hapjes së kutive të votimit me Kusht dhe VPNV, bënë regjistrimin dhe krahasimin e zarfeve me fletëvotime me listën votuese të gjeneruar në mënyrë elektronike nga procesi i votimit.
4. Në rast se gjatë skanimit evidentohet se ka pasur votim të dyfishtë, atëherë QNR pas hapjes së kutisë së votimit tërheq zarfin me fletëvotim, përgatit raport të rasteve të evidentuara dhe njofton Këshilltarin Ligjor dhe Shërbimin votues, të cilët i procesojnë te organet e drejtësisë.

Neni 15

Përputhja e rezultateve preliminare të FRS dhe FRK

1. Pas krahasimit të Listave Votuese brenda vendit, QNR bën krahasimin e numrit të nënshkrimeve me numrin e fletëvotimeve të evidentuar në FRS nga VV dhe QKN.
2. Nëse pas krahasimit numri i nënshkrimeve në LV të VV përkatës përputhet me numrin e fletëvotimeve të përdorura të evidentuar në FRS nga VV dhe QKN, atëherë rezultati i votave të atij vendvotimit konsiderohet përfundimtar.
3. Në rast të konstatimit të mospërputhjeve, kur numri i nënshkrimeve në LV është më i madh se numri i fletëvotimeve në kuti të votimit apo numri i nënshkrimeve në LV është më i vogël se numri i fletëvotimeve në kuti, atëherë rasti evidentohet dhe kutia përkatëse e votimit rekomandohet në KQZ për rinumërim.

Neni 16

Pranimi i materialit nga përfaqësitë diplomatike

1. QNR, pranon dhe verifikon materialin zgjedhor nga përfaqësitë diplomatike përmes shërbimit votues, i cili përmbanë:
 - 1.1. kutinë e votimit me fletëvotime;
 - 1.2. listën përfundimtare të votuesve;
 - 1.3. vulën dhe ngjyrën matrikuluese;
 - 1.4. fletëvotimet e papërdorura;
 - 1.5. libri i votimit;
 - 1.6. formulari i votimit në përfaqësi diplomatike – FVPD.

2. QNR, kontrollon materialin zgjedhor të secilës kuti të votimit dhe evidenton atë në regjistrin elektronik dhe formularin e pranimit të materialit të votimit nga përfaqësitë diplomatike FMPD, shtojca – III.
3. Pas pranimit dhe evidentimit, QNR shpërndan kutitë në hapësirat përkatëse për procesim dhe numërim.

Neni 17

Skanimi i Listës Votuese të Vendvotimeve në përfaqësi diplomatike

QNR menjëherë pas pranimit të Listës Votuese të vendvotimeve – VV të përfaqësive diplomatike, skanon nënshkrimet në listën fizike të votuesve.

Neni 18

Vlerësimi dhe regjistrimi i dërgesave postare me fletëvotime

1. Shërbimi Votues (SHV) bënë vlerësimin dhe regjistrimin e dërgesave postare me fletëvotime, pas përfundimit të skanimit të listës votuese të vendvotimeve në përfaqësitë diplomatike.
2. SHV krahason votuesit që kanë votuar në përfaqësi diplomatike me votuesit në LV të gjeneruar nga regjistrimi i zarfeve të votimit me postë.
3. Në rast se evidentohet se ka pasur votim të dyfishtë, atëherë SHV tërheq zarfin me fletëvotim, e shpall atë të pavlefshëm, përgatit raport të rasteve të evidentuara dhe njofton Këshilltarin Ligjor, i cili i procesonë te organet e drejtësisë.
4. Dërgesa postare me fletëvotim është e vlefshme, nëse është individuale dhe është dërguar nga personi i cili figuron në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe përmban:
 - 4.1. pullën dhe vulën postare të shtetit ku votuesi jeton;
 - 4.2. zarfin e fshehtësisë;
 - 4.3. dëftesën e regjistrimit e cila gjenerohet nga platforma elektronike.
5. Në rast të mos përmbushjes së njërës nga këto kritere të përcaktuara në paragrafin 4, zarfi me fletëvotim konsiderohet i pavlefshëm dhe refuzohet.
6. Të gjitha zarfet me fletëvotime të cilat aprovohen gjatë vlerësimit, klasifikohen në kuti të votimit, sipas komunave të Republikës së Kosovës.

7. SHV harton raport përmbledhës nga procesi i vlerësimit të pakove me fletëvotime, i cili do të përmbajë edhe arsyet e refuzimit.

Neni 19

Pranim-dorëzimi i zarfeve dhe Listës Votuese të votimit me postë nga QNR

Pas verifikimit dhe evidentimit të zarfeve të fletëvotimeve nga Shërbimi Votues, QNR pranon listat votuese të votimit jashtë Kosovës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve, shtojca – IV – Formulari i pranim-dorëzimit të zarfeve dhe Listës Votuese të votimit me postë nga QNR.

Neni 20

Numërimi i fletëvotimeve në QNR

1. KQZ obligohet të garantojë transparencë të plotë të numërimit të votave në QNR, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të teknologjisë në monitorimin, leximin apo skanimin e materialeve.
2. Në QNR numërohen fletëvotimet e:
 - 2.1. votimit me kusht;
 - 2.2. VPNV;
 - 2.3. fletëvotimet me postë;
 - 2.4. fletëvotimet e votimit në përfaqësi diplomatike;
3. Në rast mospërputhjeje, me vendim të KQZ, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) apo Gjykatës Supreme, rinumëron fletëvotimet.
4. Kriteret e vlefshmërisë së fletëvotimit dhe votës janë të përcaktuara në nenin 16 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimi.
5. Rezultatet e procesit të numërimit dhe të rinumërimit shënohen në FRS dhe FRK, të përshtatur për QKN dhe QNR, shtojca – V – Formulari i rezultateve të subjekteve dhe kandidatëve.
6. QNR aplikon metodologji të njëjtë të numërimit të votave dhe leximit të të dhënave nga formularët e rezultateve sikurse në QKN.

7. Kutitë e VPNV dhe kutitë e VV kusht, hapen dhe numërohen pas krahasimit listave votuese të përcaktuar në nenin 14 të kësaj rregullore.
8. Vendvotimet në përfaqësi diplomatike, numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore.
9. Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.
10. Ekipi i numërimit hap zarfet e konfirmuara dhe i ndan fletëvotimet nga zarfi.
 - 10.1. zarfi refuzohet nëse ai është i zbrazët apo përmban më shumë se një fletvotim të zgjedhjeve përkatëse.
11. Rinumërimi i zhvillohet sipas procedurës për verifikim dhe numërim në QKN.

Neni 21

Teknologjia mbështetëse gjatë numërimit në QNR

1. Teknologjia mbështetëse mund të instalohet në QNR. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me sistemin e teknologjisë mbështetëse përkatëse, që mundësojnë regjistrimin e procesit të numërimit dhe ofron pamje për vëzhguesit.
2. Ekipi i numërimit ka detyrimin të ekspozojë çdo fletëvotim në kamera, sipas procedurave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Me qëllim të leximit të rezultateve, KQZ mund të vendosë të përdorë sisteme të TI, që mundëson leximin elektronik të të dhënave.
4. Pas përfundimit të numërimit dhe krijimit të formularëve të rezultateve, formularët do të skanohen në QNR dhe dërgohen për publikim në ueb faqen e KQZ.
5. QNR kujdeset për ruajtjen e paisjeve, nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave deri në përfundim të punës në QNR.

Neni 22

Procedurat pas mospërputhjes së rezultateve

1. Në rast të konstatimit të mospërputhjes së rezultateve të kutisë së votimit pas rinumërimit, KQZ varësisht nga mospërputhja, merr vendim për:

- 1.1. përfshirje të rezultateve;
- 1.2. përsëritjen e votimit;
- 1.3. përjashtim të rezultateve të kutisë së votimit.

Neni 23

Procedura pas numërimit të fletëvotimeve dhe mbylljes së kutive të votimit

1. Pas mbylljes së kutisë së votimit, rezultatet dhe formularet publikohen në ueb faqen e KQZ, dhe vendosen në vende të qasshme në QNR për vëzhguesit si dhe iu ofrohen subjekteve politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës.
2. QNR tabulon rezultatet dhe të dhënat tjera, në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 24

Tabulimi dhe publikimi i rezultateve

1. QNR tabulon dhe publikon ndaras rezultatet subjekteve politike dhe kandidatëve për procesin e:
 - 1.1. votimit të rregullt;
 - 1.2. votimit me kusht dhe VPNV;
 - 1.3. votimit në përfaqësi diplomatike dhe me postë.
2. QNR tabulon dhe publikon rezultatet përfundimtare për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve të vendvotimeve të rregullta, Votimit me Kusht, VPNV, votimit përmes postës, votimit në përfaqësi diplomatike dhe përputhjes me nënshkrimet në LPV.
3. Publikimi i rezultateve përfundimtare nga QNR, përfshin:
 - 3.1. rezultatet e subjekteve politike për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe Kuvend Komunal;
 - 3.2. rezultatet të kandidatëve për Kryetar Komune;
 - 3.3. rezultatet e kandidatëve të subjekteve politike;

- 3.4. formulën e rezultateve të ndarjes së vendeve për Kuvend të Kosovës dhe Kuvend Komunal.
4. Paraqitja e rezultateve bëhet në pajtim me këtë Rregullore si dhe me Rregulloren Zgjedhore Nr. 13/2024 Rezultatet Zgjedhore.
5. Paraqitja e rezultateve të kandidatëve, bëhet sipas renditjes në listën e kandidatëve.

Neni 25

Garantimi i transparencës së numërimit në QNR

1. Me qëllim të garantimit të transparencës së numërimit, procesi i punës në secilën tavolinë të numërimit paraqitet në mënyrë të qartë dhe të qasshme për vëzhguesit.
2. KQZ siguron pamje të fletëvotimeve nga secila tavolinë e numërimit për vëzhguesit në QNR, në mënyrë që të shihet qartë secili fletëvotim.
3. Procesi i numërimit të votave nga secila tavolinë e numërimit do të transmetohet në një monitor (ekran) të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve politike.
4. Të gjitha imazhet e marra të fletëvotimeve, duhet të regjistrohen në formë digjitale gjatë gjithë procesit të numërimit të votave.
5. Në çdo imazh të transmetuar dhe të regjistruar, evidentohet numri i tavolinës në të cilën numërohen votat dhe numri i VV.
6. Në imazhet e fletëvotimeve që prezantohen në ekrane para vëzhguesve, secili imazh i fletëvotimit duhet të ketë një kod, i cili përbëhet nga kodi i VV dhe një numër rendor i rastësishëm.
7. Të gjitha imazhet e fletëvotimeve ruhen në format digjital, të cilat identifikohen në bazë të kodit sipas kësaj rregullore.
8. KQZ obligohet të garantojë transparencë të plotë të numërimit të votave në QNR, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të teknologjisë në monitorimin, leximin apo skanimin e materialeve.
9. Të gjitha aktivitetet zgjedhore brenda QNR, janë transparente dhe mund të vëzhgohen nga vëzhguesit, në pajtim me Rregulloren Zgjedhore Nr. 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve.

Neni 26
Paketimi i materialit në QNR

1. Paketimi i materialit bëhet në përputhje me procedurat e paketimit në VV.
2. Pas procesit të numërimit, materiali sistemohet në QNR.

Neni 27
Ankesat për procesin në QNR

1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP, brenda dyzetetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.
2. Paraqitja e ankesës nuk e ndërpret procesin e numërimit.

Neni 28
Rezultatet e zgjedhjeve

1. QNR, gjatë tabulimit të formularëve, në mënyrë të vazhdueshme publikon rezultatet e votave të subjekteve politike dhe të kandidatëve.
2. Procedura e publikimit të rezultateve përfundimtare bëhet në pajtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024, Rezultatet e Zgjedhore.

Neni 29
Mbyllja e QNR

1. Pas certifikimit të rezultateve, QNR vepron si në vijim:
 - 1.1. kthen objektin në gjendjen e mëparshme;
 - 1.2. përgatitë raport për punën e QNR dhe dorëzon në KQZ.
 - 1.3. evidenton dhe dorëzon në depon kryesore të gjitha pajisjet dhe materialet që ka qenë e ngarkuar dhe të pranuar nga QKN;
 - 1.4. fillon procedurat për asgjësimin e materialit zgjedhor.

Neni 30
Procedurat e QNR

Me qëllim të rregullimit të veprimeve me të detajuara të QNR, KQZ miraton procedurat e QNR.

Neni 31
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr.14/2023, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, e datës 09.03.2023.
2. Pjesë përbërëse e kësaj rregullore janë:
 - 2.1. shtojca – I – Formulari i pranim-dorëzimit nga QNR në KKZ;
 - 2.2. shtojca – II – Formulari i pranim-dorëzimit nga KKZ në QNR;
 - 2.3. shtojca – III – Formularin i pranimit të materialit të votimit nga përfaqësitë diplomatike FMPD;
 - 2.4. shtojca – IV – Formulari pranim-dorëzimit të zarfeve dhe Listës Votuese të votimit me postë nga QNR;
 - 2.5. shtojca – V – Formulari i Rezultateve të Subjekteve dhe Kandidatëve.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

